



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 16.7.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

PËR VEPRIMTARINË E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2017

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjet e datave 6 qershor dhe 17 korrik 2018, shqyrtoi raportin për veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017.

Raportimi vjetor i veprimtarisë së KLSH u krye në përputhje me kërkesat e:

- Nenit 164 të kushtetutës;
- Nenit 31 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Nenit 103 të Rregullores së Kuvendit.

Veprimtaria e KLSH është paraqitur nëpërmjet një raporti të zgjeruar të këtij institucioni, në të cilin pasqyrohen informacione të detajuara mbi veprimtarinë audituese, komunikimin dhe bashkëpunimin e tij me grupet e interesit, si dhe menaxhimin institucional dhe zhvillimin strategjik. Lidhur me veprimtarinë audituese, raporti përmban fakte dhe statistika, dinamikën e auditimeve sipas fushave kryesore, si dhe raportime mbi auditimin e performancës dhe të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Komisioni organizoi një seancë dëgjimore me Kryetarin e KLSH, i cili paraqiti një analizë të hollësishme të veprimtarisë së institucionit. Nëpërmjet një analize të detajuar që ai i bëri kornizës së matjes së performancës së institucionit, që bazohet në metodën e vetvlerësimit, rezultoi që performanca e institucionit ka qenë mjaft pozitive. Më pas ai u ndal në veprimtarinë audituese të kryer në institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, projektet me financim të huaj dhe shoqëritë anonime, duke trajtuar gjetjet kryesore dhe rekomandimet përkatëse. Ai vuri theksin në

treguesin e dobishmërisë së auditimit, i cili në vitet 2012-2017 është rritur 5 herë në krahasim me periudhën 2002-2011.

Një ndër çështjet e trajtuara nga Kryetari i KLSH-së ishte synimi për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet publike, pasi edhe këtë vit mbetet shqetësues niveli i ulët i zbatimit të tyre. Forcimi i kontrollit të KLSH-së ndaj subjekteve të audituara për zbatimin e rekomandimeve; raportimi periodik, i vazhdueshëm dhe progresiv në Komisionin për Ekonominë dhe Financat; si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional janë disa nga instrumentet për rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Relatorja e çështjes vlerësoi rëndësinë e shqyrtimit të veprimtarisë vjetore të KLSH-së, për shkak të rolit të tij si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm, që informon Kuvendin, palët e interesuara dhe publikun për mënyrën e administrimit të fondeve publike. Ajo paraqiti vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse për veprimtarinë e KLSH-së. Më pas u zhvillua seanca e pyetje-përgjigjeve dhe diskutimit të deputetëve.

Komisioni miratoi një projektrezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2017, në të cilën pasqyrohen edhe rekomandimet për vitin 2018 e në vijim. Vlerësimi i përgjithshëm është se KLSH, gjatë vitit 2017, ka realizuar misionin e tij kushtetues e ligjor, duke informuar Kuvendin, palët e interesit dhe qytetarët, në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme e të plotë, mbi përgjegjshmërinë që Qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e fondeve publike. Ky informim ka kontribuar në thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe përmirësimin e qeverisjes.

Ralizimi i misionit është një hap i rëndësishëm drejt vizionit të tij, si një institucion që nxit rritjen e përgjegjshmërisë dhe të transparencës në drejtim të përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomi të pasurisë publike, duke forcuar integritetin e institucionit dhe duke rritur besimin e publikut.

Përfundim.

Komisioni e miratoi projektrezolutën për veprimtarinë e KLSH për vitin 2017 me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje dhe ia paraqet seancës plenare për shqyrtim e miratim sipas variantit bashkëlidhur.

RELATORJA

Blerina GJYLAMETI

KRYETARI

Erion BRAÇE